



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202002209/2

Tiranë ___/___/2020

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan.*

Drejtuar: **Z. Agim ISMAILI**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Ermal KURTI
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan

ELBASAN

Të nderuar zotërinj,

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar¹, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, kreu një inspektim në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan më datë 13.02.2020, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda, znj.Nertila Qafzezi dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, garantimi i të drejtave dhe trajtimi i të paraburgosurve në bazë të akteve ligjore e nënligjore dhe dokumenteve ndërkombëtare në fuqi, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit iu ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në kqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, si dhe zhvillimin e intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në fuqi.

¹Neni 81 i ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit të inspektimit, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrojë gjetjet e këtij inspektimi, si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Inspektimi në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, u zhvillua në kuadër të vizitave periodike monitoruese për vitin 2020, që zhvillon Mekanizmi Kombëtar (MKPT) pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në institucionet penitenciare.

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në burgje, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e këtij institucioni z.Ermal Kurti, i cili u vu në dijeni lidhur me qëllimin e inspektimit.

Në vijim, drejtuesi i institucionit informoi për gjendjen e kushteve, në të cilën ndodhen ambientet ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, angazhimin e punonjësve të administratës dhe shërbimit të sigurisë për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të të paraburgosurve në këto ambiente, mënyrën e funksionimit të sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesave të të paraburgosurve, gjendjen shëndetësore dhe psiko-sociale të të paraburgosurve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, është hapur në 2 tetor të vitit 2012 dhe është i ndërtuar në ambientet e brendshme të ish-Kombinatit Metalurgjik. Nisur nga elementët e infrastrukturës dhe sigurisë të institucionit, cilësia e shërbimeve që ofrohen, si dhe ambientet e jashtme që shërbejnë për ajrim dhe aktivitete të përbashkëta, ky institucion paraburgimi sjell standarde të kënaqshme për sa i përket kushteve për të paraburgosurit.

Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 8927/1, datë 27.09.2018, “*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*”, i ndryshuar, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan është rikategorizuar si “institucion paraburgimi”. Kapaciteti i institucionit është rritur në vite, për shkak të krijimit të ambjenteve të reja të banimit dhe aktualisht kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për **144 persona të paraburgosur**, sipas miratimit të bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

Në ditën e inspektimit, kapaciteti i institucionit ishte me 143 persona të paraburgosur. Referuar statistikave për mbipopullimin në këtë institucion, për periudhën e 6 muajve të fundit, rezulton se shifrat ishin në rënie dhe në kohën e kryerjes së inspektimit, nuk kishte mbipopullim.

Më konkretisht:

1. Muaji Shtator 2019	-	159 persona të paraburgosur (+15 persona)
2. Muaji Tetor 2019	-	158 persona të paraburgosur (+14 persona)
3. Muaji Nëntor 2019	-	154 persona të paraburgosur (+ 10 persona)
4. Muaji Dhjetor 2019	-	147 persona të paraburgosur (+ 3 persona)
5. Muaji Janar 2020	-	140 persona të paraburgosur (asnjë person)
6. Muaji Shkurt 2020	-	140 persona të paraburgosur (asnjë person)

Gjatë inspektimit të kushteve në dhomat e banimit, u konstatua se nuk çënohej e drejta për hapësirë dhe sipërfaqe jetike për person. Asnjë person i paraburgosur nuk flinte në dysheme, por të gjithë ishin të pajisur me shtretër, materiale për fjetje, si dhe dhomat ishin të pajisura me orënditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale, ushqimeve etj.

Godina në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, ishin të përshtatura për të përballuar kapacitetin maksimal, si dhe dinamikën e lëvizjeve të të paraburgosurve, që ndryshonte pothuajse çdo ditë.

Organika e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan përbëhej nga 144 punonjës, nga të cilët 32 ishin punonjës civil dhe 112 punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë të institucionit.

Sa i takon masave të marra për realizimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, sipas informacionit dhe evidentimit në vend të kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit në këtë institucion, rezultoi se:

1. Ishte venë në funksion të plotë skema e rimbursimit të ilaçeve për të paraburgosurit, nëpërmjet skemës tre palëshe me depon farmaceutike dhe DRSKSH. Gjithashtu, ky institucion ishte furnizuar me medikamente, materiale mjekësore dhe materiale stomatologjike, sipas kërkesave dhe nevojave, nga depo farmaceutike e Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve.
2. Ishin përmirësuar kushtet e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe ushqimeve të të paraburgosurve, duke plotësuar çdo dhomë me dollapë për mbajtjen e tyre.
3. Ishin planifikuar masa të nevojshme nga sektori i edukimit, për punën individuale dhe në grup, që ndikojnë në rehabilitimin dhe riintegrimin e të paraburgosurve.
4. Ishin marrë masa të plota për riparimin e dusheve, dezinfektimin dhe lyerjen e ambienteve të përbashkëta.

Ndërkohë, kishte dhe një pjesë të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit që nuk ishin plotësuar. Konkretisht:

1. Nuk ishin kryer investime për instalimin e një sistemi qëndror ngrohës-ftohës në ambientin e regjimit të brendshëm, për shkak të mungesës të fondeve të planifikuara për këtë qëllim.
2. Nuk ishin krijuar ambiente të veçanta në çdo sektor, për tharjen e rrobave të të paraburgosurve dhe eliminimin e litarëve, rripave dhe telave, të cilat varen në dhoma për tharjen e tyre², duke përbërë rrezik për jetën e të paraburgosurve.
3. Institucioni ende nuk ishte pajisur me autoambulancë, për shoqërimin e të sëmurëve në rastet urgjente, kryesisht atyre me probleme të shëndetit mendor, për në spitalin rajonal Elbasan apo për në spitalet e tjera të vendit.

² Rasti i vetëvarjes me pasojë vdekjen e të paraburgosurit Bledar Doda më 23.09.2019.

4. Nuk ishte nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi mes këtij Institucioni dhe Qendrës së Formimit Profesional Elbasan, për ofrimin e kurseve profesionale të të parburgosurve.

Trajtimi i të parburgosurve

Objekti kryesor i vizitës inspektuese të grupit të monitorimit, ishte trajtimi i të parburgosurve, identifikimi i rasteve të përdorimit të forcës fizike tej kufijve të parashikuar me aktet normative, apo të presionit psikologjik ndaj tyre, si dhe përdorimi efektiv i masave disiplinore sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në aktet ligjore kombëtare dhe dhe aktet ndërkombëtare të fushës.

Nga informacioni i marrë gjatë vizitës inspektuese dhe intervistimit të të parburgosurve, grupi monitorues nuk evidentoi raste apo pretendime të personave, për tejkalim të forcës fizike nga ana e punonjësve të shërbimit të sigurisë apo stafit të institucionit.

Grupi i inspektimit, në intervistat me të parburgosurit evidentoi se kishte një numër ankesash, të cilat kishin të bënin me mugesën e aktiviteteve profesionale dhe larminë e aktiviteteve të përbashkëta kulturore dhe sportive, të cilat ndikojnë në formimin e tyre profesional, uljen e stresit psikologjik për shkak të izolimit, si dhe kalimit të kohës në mënyrë të kulturuar. Kjo problematikë është konstatuar në IEVP Elbasan edhe në vizitën inspektuese të CPT të kryer në vitin 2016. Në përgjigje të rekomandimit të CPT, autoritetet përgjegjëse të Qeverisë Shqiptare kanë theksuar se, në IEVP Elbasan (dhe institucionet e tjera të përmendura në raport), janë hartuar plane ditore/periodike për aktivitetet që duhet të zhvillohen me të parburgosurit jashtë godinës të rregjimit të brendshëm (vendet e ajrimit), me qëllim rritjen e aksesit të të parburgosurve që të marrin pjesë në këto aktivitete³. Por, ky shqetësim u evidentua edhe gjatë vizitës inspektuese për vitin 2020 nga grupi i inspektimit, në intervistat konfidenciale që zhvilloi me të parburgosurit.

Gjithashtu, një grup ankesash që u evidentua nga të parburgosurit, kishin të bënin me vonesat në kryerjen e vizitave mjekësore nga stafi mjekësor i këtij institucioni, pasi sipas tyre ato nuk ishin periodike. Disa të parburgosur ngritën si shqetësim vonesat në planifikimin e vizitave mjekësore pranë mjekëve specialist në spitalin rajonal Elbasan.

Ambientet e banimit dhe klasat në regjimin e brendshëm, ende nuk ishin pajisur me sistemie ngrohje/ftohjes, sipas kushteve klimaterike. Në mungesë të tij, ngrohja në dhoma për periudhën e dimrit realizohej me pajisje elektrike të siguruara nga vetë të parburgosurit. Sipas informacionit të drejtuesit të institucionit, godina e banimit nuk ka sistem qendror ngrohje/ftohje me kaldajë, pasi ky sistem nuk ka qënë i parashikuar në projektin e godinës në kohën kur është ndërtuar. Në përgjigje të rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit K4/I27-2 prot., datë 19.06.2019, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na informon se, është në kërkim të partnerëve mbështetës për të mundësuar fonde lidhur me investimet që duhen kryer për të pajisur ambientet e këtij institucioni me sistem qendror ngrohës-ftohës⁴.

Por ankesat më të shumta të ngritura nga të parburgosurit, konsistonin ndaj vendimeve të marra nga prokuroritë dhe gjykatat e rretheve gjyqësore për veprat penale që ju atribuhohen, por nga grupi i inspektimit ju dhanë këshillime ligjore, pasi natyra e këtyre

³ https://www.ecoi.net/en/file/local/1336989/1226_1457424142_2016-07-inf-eng.pdf (faqe 14)

⁴ Shkresë nr.5623/1 prot., datë 23.07.2019 e DPB drejtuar Avokatit të Popullit.

ankesave nuk janë objekt i shqyrtimit nga Mekanizmi Kombëtar dhe Institucioni i Avokatit të Popullit.

Masat mbrojtëse

Nga verifikimi dhe inspektimi i dokumentacioneve lidhur me sistemin e kërkesë/ankesave rezultoi se çdo ankesë regjistrohej në regjistrin përkatës dhe protokollohej⁵. Regjistrat mbaheshin nga sekretaria e institucionit.

Të paraburgosurit plotësonin një formular kërkesë/ankese dhe ia dorëzonin më pas punonjësit të sektorit psiko-social. Punonjësi i dërgonte në sekretarinë e institucionit ku protokolloheshin dhe pastaj i kalonin drejtorit të institucionit, i cili kthente përgjigje me shkrim apo takonte vetë të burgosurit.

Sa i takon objektit të kërkesave të paraburgosurve rezultoi se, ato konsistonin kryesisht për takime me familjarët, kërkesë për takim me avokatë privat të tyre, vizitë në spital te mjeku specialist, punësim ose kërkesë për blerjen e pajisjeve si TV ose frigorifer.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, monitorohej nga sistemi CCTV, me rreth 120 kamera, që vëzhgonin të gjitha mjediset në regjimin e brendshëm dhe pjesën e jashtme të institucionit, i cili ishte funksional. Kamerat monitoronin përgjatë 24 orëve dhe të dhënat e tyre ruheshin në një server qendror për një periudhë dy javore.

Sektori i observimit ndodhej në katin e parë dhe përbëhej nga 2 dhoma për të paraburgosurit, që hynin rishtaz në këtë institucion, deri sa të sigurohej përshtatja e tyre dhe dërgimi në sektor, si dhe nga 2 dhoma për qëndrimin e personave tranzit. Këto dhoma ishin të pajisura me krevat, dyshekë, materiale për fjetje dhe orenditë e nevojshme si tavolinë e karrige. Në momentin e inspektimit në këtë ambient nuk gjendej asnjë person.

Sistemi i telefonave ishte funksional dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se flisnin dy herë në javë me të afërmit e tyre nëpërmjet telefonave me kartë që ndodheshin në mjedisin e regjimit të brendshëm. Nga ana e të paraburgosurve kishte kërkesa për komunikime më të shpeshta me familjarët e tyre dhe ngritën si shqetësim kufizimin e numrit të telefonatave. Ata kërkonin që tu jepej mundësia e komunikimit më shpesh brenda mundësive të institucionit dhe sipas kushteve familjare që kishte secili prej tyre.

Nga intervistat me të paraburgosurit nuk pati ankesa për mosrespektim të numrit të takimeve me familjet, 4 takime në muaj. Takimet me familjarët zhvilloheshin në një ambient të veçantë ku ndodheshin 8 bokse, me kërkesë të të paraburgosurve dhe me miratim të Drejtorit të institucionit.

Në këtë ambient ishte krijuar një mjedis i veçantë për prindërimin në distancë, për takime të paraburgosurve me familjet dhe fëmijë të vegjël. Ata mund të takoheshin në këtë ambient pa barriera apo kufizime fizike, por dhoma kishte nevojë për investime dhe pajisje me orendi për të qenë e përshtatshme për këtë qëllim.

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan kishte në organikë 10 të paraburgosur të punësuar të cilët punonin kryesisht si pastrues, sanitarë, shpërndarës

⁵ Neni 10 i ligjit Nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".

ushqimi etj. Të paraburgosurit që punonin përfitonin nga ulja e dënimit me 3.9 ditë në muaj, për periudhën e paraburgimit.

Punësimi i të paraburgosurve/dënuarve është i rregulluar sipas neneve 43, 44 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”. Avokati i Popullit ka rekomanduar në vijimësi, për miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave, për punësimin dhe kriteret e shpërblimit për të dënuarit dhe të paraburgosurit⁶, për të bërë efektive të drejtën e punësimit dhe të shpërblimit për të paraburgosurit/dënuarit, që garantohen nga ligji dhe standardet ndërkombëtare.

Kushtet materiale

Grupi i monitorimit, inspektoi plotësimin e kushteve në ambientet e regjimit të brendshëm të institucionit, sipas kërkesave ligjore dhe në respektim të standardeve më të mira për jetesë dhe aktivitete të paraburgosurve.

Godina kryesore në regjimin e brendshëm të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, është e organizuar me 4 sektorë. Nisur nga infrastruktura e brendshme, në katin e parë ndodhen ambientet e përbashkëta për takime me familjarët, guzhina, lavanderia, dhomat e observim, dhomat e tranzitit dhe dhomat e veçimit. Veç tyre, kishte disa ambiente (dhoma) të cilat ishin pa funksion, me dyert të mbyllura dhe të vulosura për mos tu përdorur.

Në dy katet e tjerë ishin të planifikuara për akomodimin e të paraburgosurve. Në çdo kat kishte nga dy sektorë me ndarje më vete. Ndërsa në ambientin e jashtëm të godinës së banimit, ndodheshin 4 bokse për ajrimin e të paraburgosurve.

Çdo sektor kishte nga 10 dhoma për akomodimin për 2 dhe 6 persona në çdo dhomë. Sipërfaqet dhe hapësirat e dhomave ishin të përshtatura duke respektuar hapsirën jetike për person. Dritaret e dhomave kishin përmasa të tilla që lejonin të kishte ajrim dhe ndriçim të plotë natyral. Dhomat ishin me tualete brenda, të cilat kishin çezma me ujë të rrjedhshëm dhe në kushte të pastra higjieno-sanitare. Dhomat ishin të pajisura me orënditë e nevojshme si tavolina, stola dhe rafte për mbajtjen e sendeve personale dhe ruajtjen e ushqimit të të paraburgosurve. Materialet për fjetje si dyshekët, batanijet dhe çarçafët ishin në gjendje të mirë dhe të mirmbajtura.

Larja e materialeve të fjetjes bëhej në lavanderinë e institucionit, ndërsa rrobat personale laheshin nga të paraburgosurit ose familjarët e tyre. Ndërkohë, tharja e rrobave vazhdonte të kryhej në ambientet e brendshme të dhomave. Kjo përbënte një shqetësim për të paraburgosurit, por dhe stafin e sigurisë të institucionit, pasi nuk kishte një vend të posaçëm për këtë qëllim. Institucioni i Avokatit të Popullit, duke parë kushtet në dhoma dhe mundësinë e përdorimit të telave, kordonave apo litarëve që përdoren për tharjen e rrobave, si mjete që kanë shkaktuar vetëvarje nga persona në kushtet e depresionit , ka rekomanduar në inspektimin e mëparshëm heqjen e menjëhershme të tyre nga dhomat dhe krijimin e ambienteve të veçanta në çdo sektorë, për këtë qëllim. Në përgjigje të këtij rekomandimi, DPB ka sqaruar se krijimi i këtyre ambienteve është objektivisht i pamundur, për arsye të akomodimit të të paraburgosurve, por ata janë në monitorim të vazhdueshëm nga stafi i sigurisë për të parandaluar çdo risk sigurie që paraqesin këto

⁶ Nenet 43 pika 12 e ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.

mjete⁷. Ndërkohë që, grupi i inspektimit ka konstatuar gjatë vizitës inspektuese, por edhe në inspektimet e mëparshme, që në këtë institucion ka dhoma pa funksion që mund të kthehen në ambiente për këtë qëllim.

Në fundin e korridorit të çdo sektori, ndodhej ambienti i përbashkët i dusheve për larjen e trupit nga të paraburgosurit. Në këtë ambient, ndodheshin dy poste për dushe, të cilat nuk e përballonin kapacitetin për 27 persona, që kishte çdo sektor, nisur dhe nga fakti që institucioni furnizohej me ujë me orar dhe koha e furnizimit ishte shumë e shkurtër. Orari i dushit ishte planifikuar mesatarisht dy herë në javë dhe zbatohet sipas grafikut të miratuar nga drejtuesit e institucionit. **Këto ambiente kishin nevojë për mirëmbajtje, lyerje me bojë dhe disinfektimin periodik të tyre, pasi konstatohet që ato nuk ishin të pastra nga ana higjieno-sanitare.**

Ajrimi për të paraburgosurit kryhej sipas sektorëve në bokset e ajrimi, të cilat ishin të ndara nga njëra-tjetra, për arsye sigurie dhe konflikti të mundshëm mes të paraburgosurve. Një prej ambienteve të ajrimit përdorej sipas grafikut të miratuar për personat me probleme të shëndetit mendor, izolim/veçimin, si edhe për 18-21 vjeçarët (aktualisht në këtë institucion ndodheshin 5 persona të paraburgosur të moshës 18-21 vjeçare). Ky ambient përdorej gjithashtu për kryerjen e ajrimit edhe për personat e tjerë kur konstatohet se ata kishin konflikte dhe mosmarrëveshje me njëri-tjetrin.

Në çdo sektor, kishte ambiente të përbashkëta si klasat, biblioteka dhe dhoma për palestër, të cilat ishin funksionale. Aty zhvilloheshin rregullisht aktivitete në grup dhe ato individuale me të paraburgosurit, nga punojësit e sektorit psiko-social sipas programit mujor të miratuar nga drejtuesi i institucionit. Këto ambiente ishin me hapsirë të bollshme, të pajisura me orënditë e nevojshme, por mungonte larmia e materialeve dhe mjeteve në funksion të qëllimit që ato kanë, për rehabilitimin e personave të privuar nga liria. Për sa i takon aktiviteteve kulturore dhe sportive, që kërkonte pjesmarrje më të gjerë të të paraburgosurve, ato organizoheshin në bokset e ajrimit, por nga intervistat me të paraburgosurit u ngrit shqetësimi se, këto aktivitete duhet të jenë më të shpeshta dhe të larmishme.

Ambienti i takimit me familjarët ndodhej në katin e parë të godinës dhe nga intervistat me të paraburgosurit u pranua se zbatohet kriteri ligjor për 4 takime në muaj. Ambienti ishte funksional me 8 poste, takimet ishin në distancë dhe bisedat kryheshin përmes gypit telefonik.

Njëkohësisht, për të paraburgosurit që ishin familjarë, ishte krijuar një dhomë me sipërfaqe prej gati 3x4 m², e cila përdorej si ambient për prindërimin në distancë. Kjo dhomë ishte e vogël dhe nuk ishte e plotësuar me pajisje dhe orënditë e duhura për t'u konsideruar si një ambient takimi i të paraburgosurve me fëmijët e tyre. Infrastruktura e godinës dhe ambienti i jashtëm, jepte mundësinë e krijimit të një ambienti tjetër me hapsirë më të madhe se ambienti ekzistues, i cili gjithashtu duhet të jetë i pajisur me materiale informuese, shlodhëse dhe lodra për fëmijët, që të paraburgosurit të ndjehen sa më miqësor me fëmijët dhe familjet e tyre.

⁷ Shkresë nr.5623/1 prot., datë 23.07.2019 e DPB drejtuar Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, në këtë ambient kishte një dhomë për takime speciale ndërmjet bashkëshortëve, e cila ishte e pajisur me materialet dhe orenditë e nevojshme. Gjëndja higjieno-sanitare e dhomave që ndodheshin në ambientin e takimeve ishte e pastër.

Brenda po këtij ambienti, ndodheshin dhe 2 dhoma, dhoma e takimeve me avokatët privatë dhe dhoma e takimeve nga prokurorët e çështjes, të plotësuara me orenditë e nevojshme si tavolina pune dhe karrige për qëndrimin ulur të personave.

Furnizimi me ujë të rrjedhshëm kryhej nga Ndërmarrja e Ujësjetës Kanalizimeve Elbasan dhe nga pusi që ndodhej brenda territorit të këtij institucioni. Cilësia e ujit ishte e mirë, por nuk pihej nga të paraburgosurit. Furnizimi me ujë në dhoma dhe ambientin e dusheve kryhej me orar, 3 herë në ditë, sipas grafikut të miratuar. Nga intervistat, disa të paraburgosur ngritën ankesa që shpeshherë ky shërbim kishte probleme, pasi furnizimi me ujë me orar nuk plotësonte nevojat e tyre për mbajtjen e pastërtisë së ambienteve dhe të higjienës personale.

Furnizimi me detergjente, kryhej sipas normativave mujore për çdo të paraburgosur, të cilat ishin të evidentuara në një regjistër të veçantë.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan nuk kishte një njësi tregtare për ofrimin e produkteve të ndryshme për të paraburgosurit, pasi sipas drejtuesit të institucionit, nuk kishte oferta nga subjektet private për ta kryer këtë shërbim.

Kuzhina funksiononte në kushte shumë të mira dhe ishte e plotësuar me pajisjet e gatimit dhe sistemit të aspirimit të avujve. Ato ishin të standardeve industriale duke qenë se ishin vendosur së fundmi. Ambienti i kuzhinës ishte me hapsirë dhe ajrim, si dhe ishte i pastër e i lyer.

Në organikën e institucionit ishin 4 (katër) kuzhinierë, por aktualisht ishin vetëm 3 kuzhinierë dhe 2 (dy) ndihmës kuzhinier nga lista e të punësuarve të paraburgosur. Në kuzhinë ndodhej regjistri i normativave ushqimore dhe menyuja ditore ishte e afishuar. Regjistrat e kontrollit të ushqimit dhe të menisë së gatimit ishin të sekretuar dhe të protokolluar. Kampionët e ushqimeve mbaheshin në kushte frigoriferike dhe të etiketuar sipas vakteve përkatëse. Gjithashtu u konstatuan edhe racionet përkatëse për të sëmurët diabetikë në këtë institucion. Kushtet e përgatitjes së ushqimit në ambientet e kuzhinës së institucionit, rezultuan në gjendje të mirë dhe ushqimi në masën më të madhe konsumohej nga të paraburgosurit.

Regjimi dhe aktivitetet

Orari i veprimeve në regjimin e brendshëm ishte i afishuar në vende të dukshme nga personeli i shërbimit të sigurisë dhe të paraburgosurit. Ai përshkruante gjithë aktivitetin ditor nga zgjimi, rregullimi e pastrimi i dhomave, pastrimi i ambienteve të përbashkëta, vaktet e ushqimit, ora e punës edukative e profesionale, ajrimi, aktivitetet kulturore dhe sportive, etj.

Grupi i inspektimit në intervistat me të paraburgosurit, evidentoi si problematikë faktin se duhet një raport më i drejtë mes aktiviteteve individuale dhe në grup që organizoheshin në klasa, me aktivitetet e përbashkëta dhe pjesmarrjen e gjerë të të paraburgosurve në ambientin e ajrimit apo dhe sallat e bibliotekës. Në lidhje me aktivitetet, ata kishin interesa

të organizohen sa më shumë aktivitete të përbashkëta kulturore dhe sportive, por njëkohësisht të jenë dhe të larmishme.

Gjithashtu, një numër ankesash që u evidentuan nga intervistat me të paraburgosurit, kishin të bënin me hapjen e kurseve të organizuar profesionale nga institucioni në bashkëpunim me qëndren e formimit profesional të Elbasanit, pasi një pjesë e tyre e ushtronin zanatin në mënyrë individuale, duke punuar në dhomat e tyre.

Në këtë aspekt, është për tu theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin kur do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror”*⁸.

Nga verifikimi i dosjeve të punës të punonjësve të sektorit psiko-social, rezultoi të kishte programe individuale të trajtimit, si dhe pasqyrimi i organizimit të aktivitete të përbashkëta kryesisht diskutime në grup për tema sociale, këshillime në ambientet e ajrimit ose në klasat e edukimit dhe aktiviteteve sportive. Ndërsa, aktivitetet sportive ishin të kufizuara vetëm në lojra tavoline apo futboll (kalçeto) e palestër. Mungonin aktivitetet e larmishme në bashkëpunim me qëndra kulturore apo sportive të qytetit të Elbasanit, takime me shkrimtarë, artist dhe figura publike të qytetit, të cilat krijojnë atmosferë ndryshe të këta persona, sikurse ndikojnë dhe në edukimin e tyre.

Dosjet psiko-sociale ishin të plotësuar mirë, me përmbledhje nga takimet e fundit me të paraburgosurit, vlerësimet sipas tre mujoreve, si dhe gjithë dokumentat e tjera mbështetëse për çdo të paraburgosur.

Punonjësit psiko-social në këtë institucion, ishin në varësi organike të sektorit juridik dhe në takim me grupin e inspektimit, u kërkua për ngarkesën dhe përgjegjësitë që ka ky sektor, për shkak të dinamikës së madhe që kanë çështjet juridike e ligjore, do ishte në interes të rritjes së efektivitetit të punës, që të krijohej më vete sektori psiko-social dhe punonjësit e edukimit të jenë pjesë e këtij sektori.

Kontaktet me familjarët mbaheshin përmes takimeve dhe telefonatave, të cilat ishin në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Takimet realizoheshin mesatarisht 4 herë në muaj, ndërsa telefonatat realizoheshin 2 herë në javë. Takimi me familjarët zgjaste rreth 20 minuta.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, funksiononte biblioteka e cila ishte e pasur me libra, në dispozicion të të paraburgosurve për lexim sipas kërkesave. Të paraburgosurit e regjistruar kishin nga një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave.

Në këtë institucion, mungonin trajnimet profesionale, pasi Qendra Rajonale e Formimit Profesional Elbasan apo dhe organizatat e ndryshme të qytetit, nuk kishin ofruar shërbime të tilla kohët e fundit.

Shërbimi Shëndetësor

⁸Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika25.1 dhe 25.2;
<http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës monitoruese në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit të shërbimit shëndetësor ndaj të paraburgosurve, ku konstatoi se ai funksiononte përgjithësisht rregullisht.

Sipas organikës të institucionit, personeli mjekësor ishte i përbërë nga 7 punonjës, nga të cilët 1(një) mjek i përgjithshëm, 1(një) stomatolog dhe 5 (pesë) infermierë. Përgjegjësi i sistemit shëndetësor ishte mjek neurolog në organikë të spitalit rajonal Elbasan dhe njëkohësisht i punësuar në këtë institucion me kohë jo të plotë. Farmacist nuk kishte në organikë, por detyrën e tij e kryente një nga infermierët, i cili ishte i miratuar nga shërbimi shëndetësor në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtori i këtij institucioni. Stomatologu dhe personeli i mesëm infermier, punonte i gjithi me kohë të plotë. Ishte plotësuar rekomandimi i lënë dhe nga CPT-ja për pajisjen me një poltron dentar ⁹

Ambienti ku zhvilloheshin vizitat mjekësore, ndodhej në godinën kryesore në regjimin e brendshëm, i cili ishte i veçuar nga ambientet e tjera. Dhomat e vizitave dhe ato për shtrimin e të paraburgosurve, ishin me hapsirë dhe sipërfaqe të mjaftueshme, të ajrosura dhe kishin ndriçim natyral dhe nga rrjeti elektrik. Gjithashtu, ato ishin të lyera dhe të pastërta nga ana higjieno-sanitare. Në këtë ambient ndodheshin 3 (tre) dhoma për shtrimin e të paraburgosurve, dhoma e mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia, dhoma e infermierëve dhe një dhomë me 3(tre) krevatë për rastet e urgjencave.

Dhoma e mjekut ishte e plotësuar me krevatin, tavolinën, dollapin për mbajtjen e mjeteve të punës të mjekut dhe ishte e lyer. Gjithashtu, kabineti stomatologjik ishte i plotësuar me kabinetin e nevojshëm të punës, duke përfshirë dhe poltronin i cili ishte i ri.

Furnizimi me ilaçe i të paraburgosurve të sëmurë kronikë kryhej rregullisht sipas skemës të ribursimit, e cila ishte në funksion të plotë, me kontrata trepalëshe mes institucionit, depos farmaceutike dhe Drejtorisë Rajonale të Sistemit të Kujdesit Shëndetësor (DRSKSH). Gjithashtu, institucioni ishte furnizuar me medikamente, materiale mjekësore dhe materiale stomatologjike, me kërkesë nga depo farmaceutike e DPB. Në rastet e të sëmurëve akutë, përsa i përket medikamenteve që nuk ribursohen, institucioni kishte në dispozicion dhe një fond që mundësonte blerjen e tyre.

Pavarësisht mënyrës si funksiononte shërbimi shëndetësor në institucion, grupi i inspektimit evidentoi disa problematika në lidhje me kryerjen me vonesë të vizitave mjekësore nga stafi mjekësor, sikurse dhe në planifikimin e vizitave mjekësore pranë mjekëve specialistë të Spitalit Rajonal Elbasan.

Në kushtet që ndodhen të paraburgosurit që vuajnë dënimin në institucionet penitenciare, ku mundësia për të patur alternativa për marrjen e shërbimit shëndetësor në kohën dhe me cilësi është e kushtëzuar, prezenca me kohë të plotë e personelit mjekësor, merr rëndësi të veçantë. Kjo për të shmangur situatat që mund të paraqiten në rastet e urgjencave, të cilat personeli i mesëm i infermierëve, nuk mund t'i përballojë dhe pasojat mund të jenë të rënda për të paraburgosurit e sëmurë.

Në të njëjtën kohë, vonesat në miratimin e kërkesave sipas rekomandimit të mjekut të institucionit, për kryerjen e vizitave mjekësore pranë mjekëve specialist nga drejtuesit e

⁹ CPT report on Albania 2014 faqja 17

https://www.ecoi.net/en/file/local/1336989/1226_1457424142_2016-07-inf-eng.pdf

këtij institucioni, shkaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për akses te mjeku specialist i personave të dënuar apo të paraburgosur, gjë e cila është interpretuar dhe në qëndrimet e KPT (CPT-së) në këtë çështje, duke rekomanduar se: *“Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre”* dhe se *“shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme”*.

Një problematikë e cila vazhdonte të ishte evidente, pavarësisht rekomandimeve tona të vazhdueshme, kishte të bënte me mungesën e autoambulancës për shoqërimin e personave të paraburgosur të sëmurë në spitalin rajonal Elbasan apo spitalet respektive në QSUT Tiranë. Kryesisht, në rastin e shoqërimit të personave të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, të cilët kanë nevojë për vizita të shpeshta mjekësore te mjekët specialist. Aktualisht, shoqërimi i tyre bëhej me autoambulancën ekzistuese, e cila ishte shumë e amortizuar ose me automjetet e vetë institucionit.

Në përgjigje të rekomandimit të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i vitit të kaluar, DPB ka informuar se, në projekt-buxhetin e vitit 2019 është planifikuar blerja e tre autoambulancave dhe tre autoambulanca të tjera janë planifikuar të blihen gjatë vitit 2020, ku njëra prej tyre do ti shkojë I EVP Elbasan¹⁰. Por, grupi i inspektimit konstatoi se dhe për këtë vit, ky rekomandim ende nuk ishte plotësuar.

Në këtë rast, sjellim në vëmendjen tuaj Rregulloren Evropiane të Burgjeve, në të cilën thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹¹.

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan kishte një Sektor të Kujdesit të Veçantë (SKV), në të cilin gjatë periudhës Janar – Shkurt 2020 janë trajtuar 10 (dhjetë) persona të sëmurë me probleme të shëndetit mendor.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor, e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se kartelat klinike mbaheshin në një dollap të mbyllur me çelës në dhomën e mjekut. Gjithashtu u këqyrën regjistri i vizitave të mjekut dhe regjistrat e informacionit të shërbimit 24 orësh të infermierëve, të cilët ishin të sekretuar dhe të mbajtur me rregull.

Grupi i inspektimit i kushtoi një vëmendje të veçantë dhe regjistrin të evidentimit të rasteve të dhunës fizike. Plotësimi i regjistrin dhe formatet e kontrollit mjekësor ishin sipas kërkesave të Protokollit të Stambollit, lidhur me evidentimin dhe raportimin e rasteve të dhunës.

Gjatë vizitës inspektuese dhe intervistave me të paraburgosurit, u konstatua se, në tërësi të paraburgosurit ishin të pajisur me librezë shëndetësore. Për shkak të dinamikës së lëvizjeve të shpeshta të të paraburgosurve, kishte raste të mospajisjes me këto librezë

¹⁰ Shkresë nr.5623/1 prot, datë23.07.2019 e DPB drejtuar Avokatit të Popullit.

¹¹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

shëndetësore. Ndërkohë, personeli mjekësor ishte duke punuar për plotësimin me libreza shëndetësore të të gjithë të paraburgosurve.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se:

“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe, në bazë të nenit 81 pika 1 dhe 2/b të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se:

“1. Mekanizmi kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimin ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës, në vijim mekanizmi kombëtar, i krijuar në përputhje me legjislacionin për Avokatin e Popullit, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

2. Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:

b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtëruës”;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme për krijimin e ambienteve të veçanta brenda ambienteve të godinës së banimit, për tharjen e rrobave të të paraburgosurve dhe heqjen e menjëhershme për arsye sigurie për jetën të litarëve, rripave dhe mjeteve të tjera në dhoma, që përdoren për tharjen e rrobave.
2. Marrjen e masave të menjëhershme për disinfektimin e vazhdueshëm dhe lyerjen e ambienteve banimit dhe atyre të përbashkëta.
3. Marrjen e masave të nevojshme për sigurimin e fondeve lidhur me investimet që duhen kryer për të pajisur këtë institucion me sistem qëndror ngrohës-ftohës.
4. Marrjen e masave për plotësimin e institucionit me autoambulancë, me qëllim shoqërimin e të sëmurëve në rastet urgjente, si dhe atyre me probleme të shëndetit mendor, për në Spitalin Rajonal Elbasan dhe spitalet e tjera të vendit.
5. Marrjen e masave të nevojshme në bashkëpunim me ujësjellësin e qytetit Elbasan, për rishikimin e orarit ditor, me qëllim zgjatjen e orarit të furnizimit me ujë të rrjedhshëm dhe ujë të ngrohtë, në ambientet e dhomave dhe ambientet e përbashkëta për larjen e trupit të paraburgosurit.
6. Marrjen e masave të nevojshme për rishikimin e strukturës së Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Elbasan, me qëllim krijimin më vete të sektorit psiko-social.
7. Marrjen e masave të nevojshme për kompletimin e organikës të institucionit me mjek, me kohë të plotë.
8. Marrjen e masave të menjëhershme në përmirësimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor të të paraburgosurve të sëmurë, në kohë dhe pa vonesa nga ana e stafit mjekësor të

institucionit, si dhe shoqërimin e tyre për vizita mjekësore pranë spitalit rajonal Elbasan.

9. Marrjen e masave të menjëhershme nga strukturat përgjegjëse në institucion, për planifikimin dhe rritjen e larmisë të aktiviteteve kulturore e sportive me pjesëmarrjen e numri të madh të paraburgosur, në bashkëpunim me qendrat kulturore dhe sportive të rajonit Elbasan.
10. Marrjen e masave të nevojshme në bashkëpunim me Qendrën e Formimit Profesional Elbasan, për ofrimin e kurseve profesionale të të paraburgosurve në institucion apo zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për formimin profesional të tyre.
11. Marrjen e masave të nevojshme për mobilimin me orëditë e nevojshme dhe pajisjen me materiale informuese të dhomës së “prindërimit në distancë”.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditë sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA